



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike

Datë 10.02.2026

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Projekt-vendimin (titulli i projektvendimit): PËR MIRATIMIN E SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR FAMILJET PËRFITUESE QË PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT “RESTAURIMI DHE RIKUALIFIKIMI URBAN I ZONËS PERSPEKTIVE TID, ME VENDNDODHJE NË PARKUN ARKEOLOGJIK DURRËS”

Baza ligjore:

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar”, ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar, ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 384, datë 12.6.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 301, datë 15.4.2020 “Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standardet për Banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me Kosto të ulët”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 814, datë 03.12.2004 “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 107, datë 1.3.2023 Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Restaurimi dhe rikualifikimi urban i zonës perspektive TID, me vendndodhje në Parkun Arkeologjik Durrës”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 477, datë 31.7.2025 “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Restaurimi dhe rikualifikimi urban i zonës perspektive TID, me vendndodhje në Parkun Arkeologjik Durrës, me zhvillues Bashkia Durrës”, me vlerë 315,524,013.82 lekë”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.73 datë 23.12.2025 “Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm 2026-2028”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.110, dastë 16.12.2024 “Për miratimin e vlerës së shpronësimit të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken apo zhvlerësohen nga realizimi i projektit të rijetëzimit të zonës

arkeologjike "TID" Durrës, për zhvillimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore", Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.32, dastë 23.06.2025 "Për miratimin për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 110, datë 16.12.2024, "Për miratimin e vlerës së shpronësimit për pasuritë e paluajtshme, pronë private, që preken apo zhvlerësohen nga realizimi i projektit të rijetëzimit të zonës arkeologjike "TID" Durrës, për zhvillimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore", Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 41, datë 21.05.2024 "Për miratimin e vlerës mesatare të qirasë së apartamenteve të banimit për efekt të subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë",

TË VENDOSË:

Propozimi nga kryetari/këshilltarët/tjetër (*Çfarë propozohet në projektvendim*):

Kryetari i bashkisë, sipas relacionit përgatitur nga Drejtoria Ligjore dhe Drejtoria e Shërbimeve Sociale, i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë konform akteve ligjore dhe të vendosë:

1. Miratimin e subvencionimit të qirasë për familjet përfituese që preken nga zbatimi i projektit "Restaurimi dhe rikualifikimi urban i zonës perspektive TID, me vendndodhje në parkun arkeologjik Durrës".
2. Subvencionimi i qirasë miratohet deri në afatin e likuidimit të vlerës financiare të shpronësimit, por jo më shumë se 12 (dymbëdhjetë) muaj, referuar kriterëve ligjore parashikuar në ligjin nr.22/2018 "Për strehimin social", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.
3. Ky fond do të përballohet nga buxheti i Bashkisë Durrës i vitit 2026.
4. Ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria Ekonomike pranë Bashkinë Durrës, për zbatimin e këtij vendimi.

Analiza Financiare/ Buxheti total/natyra e financimit (të ardhurat e veta, transferta etj):

Fonde të buxhetit të bashkisë Durrës.

Drejtoria/Spektori përgjegjës që ka përgatitur materialin:

Drejtoria Ligjore dhe Drejtoria e Shërbimeve Sociale

Impakti social/grupet që preken:

Familjet përfituese që preken nga zbatimi i projektit "Restaurimi dhe rikualifikimi urban i zonës perspektive TID, me vendndodhje në parkun arkeologjik Durrës"

A është objekt konsultimi: (PO/JO)

JO.

Komisioni i përhershëm/përkohshëm i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, u mbledh më datë 10.02.2026, dhe shqyrtoi pikën nr. 13 të rendit të ditës, relacionin dhe dokumentat shoqërues të tij.

Komunikimi midis administratës dhe komisionit i përhershëm/përkohshëm:

Kryetari i komisionit çeli mbledhje dhe i parashtrori anëtarëve të komisionit pikën 13. Kryetari pyeti anëtarët nëse kishin pyetje apo kërkesa për pikën 13.

Për sa më sipër, pas shqyrtimit, të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese, Komisioni me shumicë votash, vendosi:

T'i propozojnë Këshillit Bashkiak:

- a- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim
- b- Miratimin e projekt aktit
- c- Refuzimin e miratimit të projektaktit
- d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si vijon:
- e- _____

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike

1	Kryetar	Marsida Feshti
2	Zv/Kryetar	Sami Osmani
3	Sekretar	Joniada Musaraj
4	Anëtar	Dorian Isaj
5	Anëtar	Elisabeta Mataj

6 Anëtar

Flutura Kasa

7 Anëtar

Edlira Shensi

8 Anëtar

Kontjana Kuçi

9 Anëtar

Erald Dalipi

